



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 14 (827818)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 7 prill 2023

Gjeneral brigade Arben Kingji: Arsimimi dhe përgatitja taktike, prioriteti ynë!

Në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar nga komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri zhvilluan takim me studentët e vitit të III, të sistemit Bachelor dhe kursantët e Kursit të Përgatitjes së Oficerit të Ri. Gjatë bashkëbisedimit me fokus mbi mundësitë që ofrojnë FA-të për të ndërtuar

një karrierë dhe të ardhme dinjitoze, gjeneral brigade Kingji tha: "Do të keni të gjithë mbështetjen e nevojshme në funksion të kryerjes së detyrave, kualifikimit/trajnimin dhe vetëzhvillimit të mëtejshëm, për një Forcë të Armatosur bashkëkohore dhe me personel drejtues të mirë përgatitur. Më tej gjeneral brigade Kingji do shprehej se: "Zhvillimet e shpejta të FASH në rrugën e integritimit të

plotë në Aleancën Euroatlantike, diktojnë konsolidimin dhe përsosjen e sistemit të arsimimit e të stërvitjes së integruar, duke i dhënë atij vlera të reja, në funksion të krijimit të përvojave dhe realiteteve të reja bashkëkohore, për garantimin e forcimit të vazhdueshëm të një shoqërie të qëndrueshme, demokratike dhe paqësore. Përbushja e misionit... >>> faqe 4



Sportistët elitare nderohen me gradën honorifike "Kolonel"

Peleshi: E përbashkëta me ushtarakët është ngritja e flamurit shqiptar nëpër botë



faqe 2-3

Efektivi i anijes "Lissus" P-133 përfundoi me sukses misionin e saj në operacionin e NATO-s, FOCOPS

Forca Detare mori pjesë për herë të parë në operacionin e NATO-s FOCOPS, me anijen LIS-SUS P-133. Pas më shumë se 20 ditësh patrullimi dhe kryerjes së detyrave special nën Komandën e Forcave Detare të Aleancës (MARCOM), efektivi i anijes "Lissus" P-133 përfundoi me sukses misionin e saj. Përveç detyrave të kryera nën komandën e MARCOM, anija "Lissus" iu përgjigj në kohë thirrjes për ndihmë velierës GINA, me flamur polka, me 3 persona në bord, e cila rrezikonte të...



faqe 5

"Ditë e hapur" në Bazën e Mbrojtjes së Emergjencave Civile, në kuadër të fushatës së rekrutimit në FA

Në Bazën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, në kuadër të fushatës së rekrutimit në FA, pas takimeve të kryera me drejtoritë e shkollave në qytetet e vendit dhe bashkëpunimit me komunitetin, u zhvillua "Ditë e hapur" me nxënësit e shkollave të mesme "Mrekullia", "Isa Buletini" dhe "Aristoteli". Të rinjtë u pritën nga komandanti i repartit, kolonel Hajdar Gurra, i cili u uroi mirëseardhjen, duke i treguar misionin dhe aktivitetin e BMEC. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti...



faqe 4

Ajo që ju thotë bota është, jeni si gjithë të tjerët, ajo që i duhet botës është që ju, të jeni ju!

A është e mundur të jetosh në shoqëri dhe të jesh i lirë prej saj? Njeriu që në fëmijërinë e tij të hershme, rrugëton nëpër procesin e shoqërizimit dhe fiton aftësi jetësore. Këto aftësi e ndihmojnë të përshtatet me jetën në shoqëri dhe të përcaktojë vendin e tij në të, ndaj dhe shfaqja e një personi dhe shfaqja e shoqërisë janë një proces i vetëm. Pa ekzistencën e njëjës, ekzistenca e tjetrës është e pamundur. Njeriu është një qenie që lind, riprodhet dhe zhvillohet në një ekip. Ai kryen role të caktuara në të dhe merr një status...



faqe 6



SPORTISTËT ELITARË NDEROHEN ME GRADËN HONORIFIKE "KOLONEL"

Klaudia Malaj

Data 6 prill shënon një kthesë në historinë e sportistëve elitare, që kanë ngritur lart nëpër botë flamurin e kombit tonë, flamurin Kuq e Zi. Emrat tashmë të njohur ndërkombëtarisht në sportet e ndryshme, si: Luiza Gega, Briken Calja, Distria Krasniqi, Erkand Qerimaj, Nora Gjakova, Alban Beqiri dhe Majlinda Kelmendi, u nderuan me gradat honorifike "Kolonel" në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë ceremoni të veçantë, të organizuar në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes në sheshin kryesor, ishin të pranishëm drejtuesit më të lartë të shtetit, si: kryeministri i vendit z. Edi Rama, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, z. Arben Kingji, ministri i Arsimit dhe Sportit znj. Evis Kushi, kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Lindita Nikolla, dhe të ftuar të tjerë përfaqësues të politikës në vendin tonë, atashe ushtarakë të akredituar në Shqipëri, si dhe nga radhët e përfaqësuesve të ministrive dhe institucioneve të tjera.

Mbi tapetin e kuq, me simbolikën e motos "Bashkimi i së Tashmes dhe së Ardhmes", parakaluan sportistët elitare, të shoqëruar nga fëmijë aspirantë për të ardhmen e sportit dhe uniformës ushtarake.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi uroi mirëseardhjen në familjen e madhe të Forcave të Armatosura të sportistëve elitare, të cilët tashmë do të jenë në radhët e Kolonelleve të Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes theksoi në fjalën e tij se: "E përbashkëta mes sportistëve elitare dhe ushtarakëve të Forcave të Armatosura është flamuri Kuq e Zi. Ka një zjarr në zemrën e ushtarakut dhe në zemrat e sportistëve. Ky zjarr, është dashuria për Shqipërinë." Ai tha se kjo e përbashkët i jep legjitimitet të plotë dhe mbështetje morale të jashtëzakonshme këtij gjesti të Qeverisë Shqiptare dhe të Kuvendit të Shqipërisë, në dhënien e gradave të larta të sportistëve elitare, që nën flamurin e Shqipërisë kanë arritur rezultatet më të larta kudo në botë.

Peleshi vijoi duke u shprehur se: "Po kështu edhe Forcat e Armatosura e

Peleshi: E përbashkëta me ushtarakët është ngritja e flamurit shqiptar nëpër botë



kanë mbajtur lart dhe dinjitoz flamurin e Shqipërisë, të paktën në shtatë vende në shtatë misione sot në botë. Në kuadrin e Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Europian dhe mbi të gjitha Misioneve dhe Operacioneve të NATO-s.

Ministri Peleshi theksoi se, sot, ushtarakët marrin një trajtim dinjitoz në radhët e ushtrisë, por edhe në pagë, ku krahasuar me vitet e tjera, pagat për ushtrinë shqiptare janë rritur me rreth 40%, nga ushtarit bazë deri në radhët e gjeneralëve dhe inkurajoi se lajme të mira do të ketë shumë shpejt për ushtarakët në vendin tonë.

Ministri i Mbrojtjes tha se: "Dhënia e një grade madhore në Forcat e Armatosura është padyshim nderi më i madh që mund të të japë vendi yt, edhe gjurma më e fortë që lë në historinë tënde personale edhe familjare".

Në fjalën e tij mbyllëse ministri Niko Peleshi u bëri thirrje të rinjve dhe të rejave, të bëhen pjesë e Forcave të

Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

I pranishëm në këtë eveniment dhe mbështetës i madh i sportit, kreu i Qeverisë, z. Edi Rama përshëndeti sportistët elitare, duke i cilësuar si djem dhe vajza të përkushtuar në drejtimet e

tyre. "Vijmë sot këtu, për të kurorëzuar një përpjekje që ka filluar prej kohësh, duke u dhënë dorën sportistëve tanë më të mirë dhe duke u bërë të mundur atyre të stërviten, të ndjehen ngrohtë në vendin e tyre, ta përfaqësojnë me

dinjitet Shqipërinë."

Kryeministri Rama tha se në sport po kurorëzohet një përpjekje që ka filluar prej kohësh, duke u bërë të mundur sportistëve ta përfaqësojnë me dinjitet Shqipërinë.

"Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për këta fëmijë dhe të gjithë të rejtat e rinjtë, që dëshirojnë për t'u marrë me sport, për t'i ngjarë përditë kampionëve tanë, do ta kenë edhe më të motivuar nga bindja se do të ngjiten një ditë në këtë podium, pasi të jenë ngjitur në podiume në arenat ndërkombëtare të sportit. Se nuk do të jenë kampionë të harrur e njerëz të braktisur, por do të kenë mundësinë e një page dinjitoze, deri në fund të jetës aktive, por edhe një pensioni përkundër gradës. Do të kenë mundësi të garantojnë kontributin e merituar për familjet e tyre", - tha ai.

Kryeministri u ndal edhe te kampionet olimpike të Kosovës, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"



Distria Krasniqi, të cilat ndodhen këtu jo vetëm si qytetare të Republikës së Shqipërisë, por edhe si shembuj që shkëlqejnë në sytë e gjithë të rinjve.

“Janë shembuj talenti, vullneti, suksesi por edhe shembujt e një patriotizmi të shëndetshëm dhe të dobishëm dhe që ushqen me oksigjen organizmin e këtij kombi, jo përmes urrejtjes ndaj të tjerëve, as përmes dashurisë me fjalë për atdheun, por përmes forcës mbresëlënëse të shembullit të tyre.

Kemi sot këtu 7 kolonelë, që kanë ngritur lart nëpër botë flamurin kuqez të Shqipërisë dhe flamurin verdh e blu të Kosovës dhe sot ata janë të gjithë bashkë, të bashkuar nën flamurin kuqez, shëmbëlltjërë frymëzuese e bashkimit të forcave, zemrave, syve dhe mendjeve, për ta bërë atdheun tonë burimin e një krenarie të pa negociueshme nga çdo shqiptar që lind në trojet e shqiptarëve. Burimin e një krenarie që nuk vihet në pikëpyetje as nga vështirësitë, as nga peripecitë, as nga pengesat e asnjë gjë tjetër. Ndërsa Luiza Gega nuk kishte shtet pas shpinës, që ta shtynte të vraponte më shpejt. Sot Luiza Gega është shëmbëlltjërë e shtetit, e një shteti që do të ecë shumë përpara e do t'i bëjë krenarë të gjitha ‘Luizat’ e vogla”, - tha ai.

Kryeministri Rama nuk la pa përmendur edhe të shkuarën e trishtë, përmes të cilës sportistët shqiptarë kanë kaluar. “Ata kanë ngritur flamuj të shteteve të tjera nëpër aktivitetet ndërkombëtare që kanë zhvilluar, sepse shteti i tyre nuk i jepte asnjë mundësi të luftonin për flamurin tonë kombëtar.”

Kreu i Qeverisë kujtoi mungesën e bazës materiale, mungesën e infrastrukturës për zhvillimin e



sportistëve në vendin tonë. Z. Rama theksoi se ata janë njohur nga vende të huaja për herë të parë, kur janë larguar nga Shqipëria. Largime këto, të bëra “për një palestër, për trajtim ushqimor dinjitoz dhe për të pasur në krah trajnerë të motivuar. Në pamundësi për të përfaqësuar atdheun e tyre, së paku të

përfaqësonin forcën e talentit dhe të pasionit të tyre”.

Kryeministri Rama e cilësoi si një dështim të qeverive të shkuara shqiptare, të cilët nuk mundën të kontribuonin për sportistët elitare.

“Kampionët shqiptarë tanimë të dalë përfundimisht nga zona e errët

e braktisjes dhe harresës nga shteti do të jenë mes ushtarakëve tanë, mes gjithë atyre përpjekjeve për ta ngritur lart ushtrinë tonë, duke dhënë forcën e shembullit të tyre në dispozicion të stërvitjes psiko-fizike të Forcave të Armatosura”, - tha kryeministri Rama.

Nuk mund të mungonte as fjala

përrshëndetëse e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji.

Gjeneral brigade Arben Kingji, si lideri ushtarak i Forcave të Armatosura u shpreh se: “Dhënia e gradave honorifike ushtarake për këto vajza dhe djem padyshim që është një vlerësim dhe mirënjohje më shumë se e merituar. Këto grada janë simboli i dedikimit dhe respektit i të gjithë shoqërisë dhe kombit tonë. Sportistët vijjnë në shtëpinë e tyre, janë në shtëpinë e tyre dhe do të jenë gjithmonë të mirëpritur dhe të vlerësuar. Është rasti të pohoj se Forcat e Armatosura kanë gjetur një vëmendje dhe një besim të shtuar të qeverisë, i konkretizuar me një mbështetje të gjithanshme. Sot Forcat tona të Armatosura, si anëtare të Këshillit Kombëtar të Sporteve Ushtarake, kanë marrë pjesë në shumë aktivitete sportive ndërkombëtare, duke arritur rezultate të larta”. Në fjalën e tij mbyllëse, gjeneral brigade Arben Kingji uroi mirëseardhjen e sportistëve elitare në radhët e ushtarakëve.

E pranishme në këtë aktivitet, ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Evis Kushi u shpreh se këto grada honorifike në radhë të parë janë falë meritës, talentit, punës, sakrificës së tyre, por që sporti është prioritet i qeverisë shqiptare.

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Evis Kushi theksoi se: “Ne sot kemi një kuadër ligjor të përmirësuar, të përafëruar me Bashkimin Europian. Kemi një Vendim të Këshillit të Ministrave që i shpërblen me dinjitet sportistët tanë elitare, ashtu edhe trajnerët e tyre.”

Të gjithë një zëri u urojmë mirëseardhjen sportistëve tanë elitare në familjen tonë të madhe të Forcave të Armatosura.



Gjeneral brigade Arben Kingji: Arsimimi dhe përgatitja taktike, prioriteti ynë!

Në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar nga komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri zhvilluan takim me studentët e vitit të III, të sistemit Bachelor dhe kursantët e Kursit të Përgatitjes së Oficerit të Ri.

Gjatë bashkëbisedimit me fokus mbi mundësitë që ofrojnë FA-të për të ndërtuar një karrierë dhe të ardhme dinjitoze, gjeneral brigade Kingji tha: “Do të keni të gjithë mbështetjen e nevojshme në funksion të kryerjes së detyrave, kualifikimit/trajnimin dhe vetëzhvillimit të mëtejshëm, për një Forcë të Armatosur bashkëkohore dhe me personel drejtues të mirë përgatitur. Më tej gjeneral brigade Kingji do shprehej se: “Zhvillimet e shpejta të FASH në rrugën e integritetit të plotë në Aleancën Euroatlantike, diktojnë konsolidimin dhe përsosjen e sistemit të arsimimit e të stërvitjes së integruar, duke i dhënë atij vlera të reja, në funksion të krijimit të përvojave dhe realiteteve të reja bashkëkohore, për garantimin e forcimit të vazhdueshëm të një shoqërie të qëndrueshme, demokratike dhe paqësore. Përmbushja



e misionit të FASH kërkon, në radhë të parë, personel të arsimuar, të mirë stërvitur, por edhe të motivuar. Për këtë qëllim, vëmendje e veçantë t'i kushtohet arsimimit dhe stërvitjes së fokusuar nga misioni, në përputhje me standarde reale, që u përgjigjen nivelit të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe atyre të NATO-s.”



Përfundon Kursi Bazë i Oficerit të Logjistikës

Në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Oficerit Logjistik. Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben Dhuli dhe komandantë repartesh. Në këtë kurs, oficerët morën njohuritë bazë për logjistikën, duke u fokusuar në detyrat dhe veprimtarinë mbështetëse që kryen nënrepartit logjistik në operacione luftarake dhe jo luftarake. Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i kësaj qendre, kolonel Ylli Zyla, i cili iu uroi kursantëve përfundimin me sukses të këtij kursi dhe shprehu bindjen e tij se njohuritë e tyre do të vlejnin në kryerjen e detyrave në Forcat e Armatosura.

Më pas fjalën e mbajti shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben Dhuli, i cili theksoi rëndësinë që ka përgatitja e lartë si teorike dhe praktike në kryerjen e detyrave në Sektorin e Logjistikës.

Ceremonia vazhdoi me shpërndarjen e certifikatave të kursantëve.



“Ditë e hapur” në Bazën e Mbrojtjes së Emergjencave Civile, në kuadër të fushatës së rekrutimit në FA

Në Bazën e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, në kuadër të fushatës së rekrutimit në FA, pas takimeve të kryera me drejtoritë e shkollave në qytetet e vendit dhe bashkëpunimit me komunitetin, u zhvillua “Ditë e hapur” me nxënësit e shkollave të mesme “Mrekullia”, “Isa Buletini” dhe “Aristoteli”.

Të rinjtë u pritën nga komandanti i repartit, kolonel Hajdar Gurra, i cili u uroi mirëseardhjen, duke i treguar misionin dhe aktivitetin e BMEC. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i KM-së, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i QPR-së, kolonel Altin Gjetaj dhe komandantët e reparteve vartëse. Në fjalën e tij, gjeneral brigade Xhebexhia iu shpjegoi të rinjve rëndësinë që ka pjesëmarrja në Forcat e Armatosura. Kolonel Gjetaj nga ana e tij u bëri thirrje nxënësve maturantë të jenë pjesë e FA-së, pasi futja në radhët e ushtrisë sjell përfitime për ta dhe për familjet e tyre.

Gjatë ceremonisë, repartet e Komandës Mbështetëse demonstruan mjetet e pajisjet e tyre, ku nxënësit u njohën me përdorimin dhe iu shpjegua veprimtaria e reparteve të KM-së në Emergjencat Civile dhe në ndihmë të komunitetit.

Në vazhdim të fushatës së rekrutimit, përfaqësuesit e QPR-së njohën të rinjtë për misionin e FA-së dhe detyrën e ushtarakut si dhe u dhanë informacionin e nevojshëm për t’u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.



Kontingjenti KFOR-3 i efektivëve të batalionit II të Këmbësorisë, tregoi performancë të shkëlqyer në stërvitjen COBWEB në Gjakovë, si dhe gjatë trajnimit ‘Fire Fobia’ dhe ‘kontroll turmarsh’, së bashku me trupat aleate në bazën ‘Camp Villaggio Italia’, Pejë, Kosovë.



Vijon rritja e kapaciteteve operacionale dhe kompaktësimi i veprimeve taktike të strukturave të FA-së (Regjimenti i Operacioneve Speciale), nëpërmjet trajnimeve/stërvitjeve në nivel grupi dhe nivel regiment-batalioni, duke testuar njëkohësisht elementët e komandim-kontrollit dhe kondicionit fizik të efektivëve.



Efektivi i anijes "Lissus" P-133 përfundoi me sukses misionin e saj në operacionin e NATO-s, FOCOPS

Forca Detare mori pjesë për herë të parë në operacionin e NATO-s FOCOPS, me anijen LISSUS P-133. Pas më shumë se 20 ditësh patrullimi dhe kryerjesh së detyrave special në Komandën e Forcave Detare të Aleancës (MARCOM), efektivi i anijes "Lissus" P-133 përfundoi me sukses misionin e saj. Përveç detyrave të kryera nën komandën e MARCOM, anija "Lissus" iu përgjigj në kohë thirrjes për ndihmë velierës GINA, me flamur polka, me 3 persona në bord, e cila rrezikonte të mbytej, duke iu dhënë ndihmën e kërkuar dhe shpëtuar personat në rrezik.

Në përfundim të operacionit, komandanti i Grupit të Organizuar për detyrë (Task Group), kapiten i rangut III Josip Zupa, komandanti i anijes kroate HRVS DUBROVNIK 42, kapiten lejtant Dino Cobo dhe Komandanti i anijes "Lissus" P-133, kapiten lejtant Lorenc Demiri zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare. Shefi i shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut I Arsen Mullaj, në emër të Forcës Detare falënderoi efektivat e anijeve për kryerjen me sukses të misionit.

Në brifingun e zhvilluar ndërmjet Komandës së Forcave Detare të Aleancës (MARCOM) dhe Komandantëve të anijeve pjesëmarrëse në operacionin FOCOPS, në përfundim të misionit, MARCOM shprehu vlerësimet më të mira për performancën e anijes "Lissus", e cila bashkë me ani-



jen Kroate HRVS DUBROVNIK 42, kryen operacione për rritjen e sigurisë detare në Detin Mesdhe.

Kontributi i dhënë për sigurinë lundimore kombëtare dhe asaj të Aleancës është prioritet i Forcës Detare.



Në Portin e Vlorës u zhvillua "ditë e hapur" dhe vizitë në anijen P-132 "Oriku"



Forca Detare në bashkëpunim me Qendrën e Personel Rekrutimit, organizoi një "ditë të hapur" me gjimnazistët e shkollave të mesme të qytetit të Vlorës, "Halim Xhelo", "M. Q. Ataturk", "Jani Minga". Gjimnazistët, të shoqëruar nga mësuesit e tyre, u njohën nga afër dhe me pajisje të ndryshme nga Qendra e Zhytjes dhe funksionet e anijes. Nga efektivi ushtarak i Forcës Detare dhe personeli i QPR-së, nuk mungoi informacioni për të gjithë nxënësit që treguan interes dhe dëshirojnë të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura.

Delegacioni i Organizatës Ndërkombëtare të Ndihmës në Lundrimin Detar (IALA) realizoi një vizitë në Forcën Detare

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra dhe komandanti i Shërbimit Hidrografik, kapiten i rangut III Artan Malo, priti delegacionin e Organizatës Ndërkombëtare të Ndihmës në Lundrimin Detar (IALA). Delegacioni kryesohej nga Sekretari i Përgjithshëm z. Francis Zachariae dhe shoqërohej nga oficeri për marrëdhëniet me jashtë dhe anëtarësimet znj. Lorraine Mbong.


Kjo vizitë është e një karakteri historik për Forcën Detare dhe Shërbimin Hidrografik në veçanti, pasi u miratua nënshkrimi i anëtarësimin të vendit tonë në këtë organizatë pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë. Gjatë vizitës u zhvillua një takim pune midis dy palëve, gjatë të cilit u diskutua mbi hapat e mëtejshëm për integrimin e Shërbimit Hidrografik në familjen e IALA-s, projektet e zhvillimit të sistemit të sinjalistikës detare, arritjen e standardeve ndërkombëtare, si dhe trajnimet.



Gjeneralmajor Gëzim Hazrolli dhe gjeneralmajor Enver Cikaqi, lektorë VIP për Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë priti ditën e sotme si lektorë VIP, gjeneralmajor Gëzim Hazrollin, drejtor i Drejtorisë së Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës dhe gjeneralmajor Enver Cikaqi, zëvendës komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ata mbajtën leksion për Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-13) mbi temat: "Mjedisi i sigurisë në Kosovë, rast studimor" dhe "Institucionalizmi i bashkëpunimit për sigurinë e Kosovës, rast studimor".

Pjesëmarrësit e kursit treguan interes për temat, adresuan pyetje dhe diskutuan mbi temat e prezantuar. Në vijim gjeneralët zhvilluan takim me kursantët pjesëmarrës nga Forca e Sigurisë së Kosovës në kurset që zhvillohen pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Vizitat u mbyllën me foto të përbashkëta.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ajo që ju thotë bota është, jeni si gjithë të tjerët, ajo që i duhet botës është që ju, të jeni ju!

A është e mundur të jetosh në shoqëri dhe të jesh i lirë prej saj?

Njeriu që në fëmijërinë e tij të hershme, rrugëton nëpër procesin e shoqërizimit dhe fiton aftësi jetësore. Këto aftësi e ndihmojnë të përshtatet me jetën në shoqëri dhe të përcaktojë vendin e tij në të, ndaj dhe shfaqja e një personi dhe shfaqja e shoqërisë janë një proces i vetëm. Pa ekzistencën e njëjtës, ekzistenca e tjetrës është e pamundur. Njeriu është një qenie që lind, riprodhohet dhe zhvillohet në një ekip. Ai kryen role të caktuara në të dhe merr një status të përshtatshëm shoqëror që përcakton personalitetin e tij dhe e bën një person përfaqësues të një mënyre të caktuar të jetës.

Ashtu si shoqëria ndikon në një person, një person ndikon në shoqëri, investon aftësitë e tij në zhvillimin e saj, gjë që gjithashtu kontribuon në përparimin shkencor. Pa një ndërveprim të tillë, nuk do të kishte shkencë dhe art, gjithashtu njerëzit do të privoheshin nga shumë zbulime dhe shpikje.

Shoqëria është një forcë e fuqishme

Një person nuk mund të jetojë jashtë shoqërisë. Megjithatë, një numër i madh ligjesh të shkruara për të mbrojtur një person nga shoqëria tregojnë se, jo gjithçka është normale në marrëdhëniet midis qytetarëve dhe shoqërisë.

Kemi frikë të dalim në mbrëmje sepse jemi të kërcënuar pafundësisht nga mashtruesit në rrjete sociale...

Duke hyrë në jetë, ne jemi tashmë të frikësuar nga rreziqet që kërcënojnë kjo botë e pakëndshme dhe ndonjëherë sinqerisht e ligë.

Si ta jetoni jetën tuaj sipas planit tuaj? Si të mos thyheni nën goditjet e fatit?

Shoqëria mund të ndikojë në jetën e çdo personi. Askush nuk është imun nga diskutimi, gjykimi, thashethemet. Të gjithë mund të gjendemi në një situatë të pashpresë dhe kjo varet nga mënyra se si silllet shoqëria. Ndikimi i tij nuk mund të injorohet.

A mund të mbetet një person i qytetëruar jashtë shoqërisë?

Zoti e krijoi errësirën që drita të ketë kuptim, krijoi injorancën që dituria të ketë kuptim, krijoi varfërinë që pasuria të ketë kuptim, krijoi



sëmundjen që shëndeti të ketë kuptim, krijoi egoizmin që altruizmi të ketë kuptim, krijoi dështimin që sukcesi të ketë kuptim, krijoi regresin që progresi të ketë kuptim etj.

Për të qenë produktiv në jetë, duhet të kesh vizionin dhe mënyrën e realizimit të tij. Është vizioni ai që të dërgon drejt përparimit dhe drejt një progresi që mendon se duhet të arrihet.

Por në realizimin e vizionit, njeriu përballet me sfida dhe vështirësi, gjë që, nëse nuk i menaxhon si duhet, mund t'i kushtojnë edhe me dorëzimin përballë tyre. Një thënie e urtë lidhur me këtë thotë: "Rruga drejt realizimit të qëllimit është e gjatë dhe në të ka shumë sfida, qëllimi ynë duhet të jetë që të ecim me këmbët e breshkës (ngadalë, por sigurt) por të arrijmë në fund, dhe jo të nxitohemi me hapat e lepurit dhe të mbetemi në gjysmë të rrugës".

Njeriu për nga natyra e tij është i dobët dhe shpesh nga vështirësitë e shumta ndjen lodhje, prandaj ai duhet të përkrahet nga familja dhe shoqëria

e tij që të arrijë në destinacionin final.

Ekziston një faktor kryesor që njeriun e le mbrapa, ai është: të menduarit e tepërt rreth gabimeve të së kaluarës dhe mendimi i tepërt për të ardhmen gjë që kontribuon që një individ të mos e shijojë kohën e tashme dhe t'i marrë masat e duhura për të arritur sukses. Prandaj për t'i ikur këtij problemi është e mjaftueshme që të mos mendohet e kaluara sepse sjell dëshpërim, dhe të mos mendohet tepër e ardhmja ngase ajo është në dorën e Sunduesit, por të merren të gjitha masat që duhet për ta shfrytëzuar në mënyrë sa më efektive kohën e tashme. Si një faktor i rëndësishëm që ndihmon në realizimin e qëllimit është edhe të pasurit e një shoku të rrugës, i cili të këshillojë, kritikojë, të përkrahë dhe të ndihmon vetëm e vetëm që rruga të të duket më e lehtë

E bukur thënia: 'Mos ec kundër të tjerëve, por ec me të tjerët. Kush ec vetëm e gabon rrugën, ndërsa kush ec me të tjerët gjen rrugë të reja'.

Para se të zgjedhësh rrugën, është

shumë e rëndësishme ta zgjedhësh bashkudhëtarin. Të shoqëruarit dhe komunikimi me njerëzit ndihmon shumë njeriun drejt progresit, për dallim nga të izoluarit dhe të qëndruarit, i cili e lë në baltën e injorancës dhe të errësirës.

A është sukses vetëvlerësimi për veten?

Ai që e vlerëson veten, vlerësohet shumë nga të tjerët, në dallim nga ai që nuk e vlerëson veten e tij mbetet i zhvlerësuar edhe nga të tjerët.

Një histori e bukur dhe mjaft domethënëse është ajo që i ka ndodhur mendimtarit të njohur francez: Ai e kishte mësuar shërbëtorin e tij që çdo ditë në mëngjes, kur ta zgjonte nga gjumi t'i përsëriste këto fjalë: "Zgjuhuni zotëri! Zgjuhuni se u presin punë madhore për t'i përfunduar, punë të cilat do i shërbejnë njerëzimit!"

Kështu, ai zgjohej gjithë energji dhe vullnet, plot shpresë, optimizëm dhe vitalitet. Ai besonte se është njeri i rëndësishëm dhe mendonte se ekzistenca e tij do i shërbejë jetës, e cila priste shumë prej tij.

E çuditshme është se mendimtari nuk kishte ndonjë profesion apo post të rëndësishëm. Puna e tij e vetme ishte të lexuarit, të shkruarit dhe përmbushja e misionit, të cilin i kishte ngarkuar vetes, i cili përmbledhet në thirrjet për krijimin e një jete të ndershme të bazuar në bashkëpunim dhe jo konfliktin e egër kapitalist për jetë a vdekje. Ai i besonte fuqishëm këtij objektivit dhe e konsideronte veten si burim i shpresës për një jetë më të bukur dhe më të këndshme.

Nuk e kuptoj përse shpesh na ndodh të shohim veten të vogël dhe të pavlerë! Përse të mos kemi objektiva në jetën tonë, e mandej t'i deklarojmë vetes dhe botës se po vijmë rrugës

së realizimit të tyre me qëllim që të ndryshojmë botën, qoftë dhe një pëllëmbë vend të saj?

Është një ndjenjë e mrekullueshme, është një emocion i papërshkrueshëm ai që ndjen njeriu, i cili i beson rolit të tij në shërbim të njerëzimit, ai që i beson ndikimit pozitiv në shoqëri.

Cilat janë objektivat madhore që na presin neve?

Kjo është një pyetje, e cila mund t'i lindë secilit. Më lejoni që t'ju ndihmoj në përgjigjen e kësaj pyetjeje. Çdo njeri nga ne, gëzon aftësitë e duhura për t'i caktuar vetes një objektiv madhor dhe të dobishëm për njerëzimin. Thjesht premtimi që i bën vetes për të bërë një jetë të ndershme, është në vetë një objektiv madhor dhe punë e ndershme, të cilën njerëzimi e pret me 'mall'. Kryerja e punës tënde në mënyrën më të mirë, kontributi shoqëror dhe shpirtëror, nuk janë veçse vepra madhore, të cilat pak njerëz i kryejnë siç duhet.

Sot, bota nuk pret prej nesh të jemi një Ajsnhtajn i dytë, as dhe një Adam Smith bashkëkohor.

Tërësia e aftësive tona mund të mos renditet tek gjenialët dhe novatorët e botës. Megjithatë, ne nuk jemi pa aftësi, talente dhe cilësi që na dallojnë nga shumë njerëz të tjerë.

Nëse këto arrijmë ti vëmë në praktikë, do i bëjmë njerëzit shërbime të vjera. Prej nesh pritet thjesht të vlerësojmë veten dhe aftësitë e tona, si dhe t'i caktojmë vetes një objektiv në jetë.

Një nga formulat dhe ligjet e njohura të jetës është se ajo të trajton në bazë të vlerës që i ke caktuar vetes. Nëse e sheh veten të rëndësishëm, gjë e cila buron nga forca e vullnetit dhe objektivit tënd, e gjithë bota do të përsërisë pas teje himnin e krenarisë dhe vlerësimit. Por kur e sheh veten si një njeri të pavlerë, si shumë miliona të tjerë që jetojnë mbi faqen e tokës, mos ironizo fatin dhe jetën, e cila të ka hedhur në një cep, ku askujt nuk i bën përshtypje ekzistenca apo mungesa jote. Prandaj, e dashur vetja ime zgjohu dhe ec përpara! Të presin shumë punë të rëndësishme dhe madhore, të cilat do i shërbejnë njerëzimit!

Mëso të jesh optimist dhe refuzoje pesimizmin, mëso të jesh i duruar, ata që kanë durim e kanë fundin më të rehatshëm! Rrugëtimi ndaj së panjohurës është i vështirë dhe shpesh me surpriza jo dhe aq të këndshme, por në fund kjo na bën më të fortë.

Është shpirti dhe jo vitet ato që përcaktojnë moshën tënde, rrudhat e ballit nuk duhet të rrudhin vijat e zemrës. Vuajtjet janë vija e startit të nisjes plot vrull. Dëshimi është foltorja e suksesit. Dhe e gjithë kjo ndikohet drejtpërdrejt nga ty, ju, ata, shoqëria, e cila duhet të ndihmojë që në vijën e rrezikut të saj ta marrë pas!



Partizani dhe skënderbegasi Lulo Musai, komandanti i parë i Regjimentit të Helikopterëve në Shqipëri

Lulo Musai u lind në Smokthinë, Vlorë, më 15 janar të vitit 1929. Në periudhën 1938-1941 mbaron shkollën fillore në Shalës, Mesaplik; në periudhën, dhjetor 1943-mars 1945, partizan në Brigadën e 5-të Sulmuese; në periudhën 1945-1948 përfundon ciklin 7-vjeçar dhe shkollën Ushtarake “Skënderbej”; në periudhën 1948-1952 kreu studimet për pilot në ish-Bashkimin Sovjetik (Novosibirsk, Siberi); në periudhën 1952-1954, komandant skuadrilje (Laparakë, Tiranë); në periudhën 1954-1959, pilot e drejtues në regjimentin luftarak, Kuçovë; në periudhën mars-qershor 1958 dhe maj-tetor 1959, specializim e kualifikim në Bashkimin Sovjetik; në periudhën 1959-1967, pilot e më pas komandant i skuadriljes së MIG-19, në regjimentin luftarak, Rinas; në periudhën tetor-nëntor, 1960 rikualifikim në Bashkimin Sovjetik për avionin supersonik Mig-19; në periudhën tetor 1963 merr titullin “Pilot i Klasit të Parë”; në periudhën 1964-1967, komandanti i skuadriljes Mig-19, në Rinas; në periudhën 1967-1975, komandant i regjimentit të helikopterëve, Farkë-Tiranë; në vitin 1975, nxirret në lirim para kohe. Ndahet nga jeta më 7 nëntor 1988. Për merita në luftë e punë, në shërbim të mbrojtjes së Atdheut është nderuar me 12 Medalje e dekorata.

Miqtë e tij e kujtojnë: “Ishte pragu i luftës së Kosovës. Në regjimentin e Farkës do të dislokohehin 5-6 njësi të ndryshme të aleatëve të NATO-s, kryesisht mbështetës, ndërlihdje, zbulimi dhe logjistike. Të parët mbërritën spanjollët, një kompani ndërlihdjeje, të cilët kishin në përbërje veç antenave e mjeteve lokative dhe tre a katër helikopterë të vegjël si pilivesa. Veç kabinës së xhamtë, konstruksioni i tyre ishte i tëri metalik. Ata përdorëshin për zbulim. Komandantit të kësaj kompanie, me një emër aspak spanjoll, Mikelanxhelo, bashkë me komandantin e regjimentit, Beqir Barxha, po i tregonim diçka nga historiku i regjimentit tonë. Mbas një rikonicioni të shkurtër nëpër repart u gjendëm në sheshin para godinave. I thamë se ‘arkitekti’ i gjithçkaje këtu ishte një ish-pilot supersoniku, madje i pari në Aviacionin shqiptar. ‘Ku e ka bustin ky burrë?’ - na pyeti duke vështruar rrotull. Ishte e vështirë t’i shpjegonim homologut tonë se ish-legjenda e qiellit shqiptar, jo vetëm që nuk kishte bust në hyrje apo në mes të repartit (siç edhe e meritonte), por ai u persekutua për vite të tëra, fare pa shkak... Kur e kam njohur, në nëntor të 1970-ës, ai ishte vetëm 41 vjeç. Një burrë me trup të bëshëm, me kokë të madhe, hundë të rrumbullakët, vetulla të trasha, gati-gati të bashkuara. Kur ishte me kapele në kokë, ajo ia mbulonte atë ‘aerodrom’ që i bashkonte ballin me ‘pistën’ e kufizuar anash me atë tufë flokësh që i dilte si xhufka resh të zbardhura. Në pamje të parë të dukej sikur kishe përpara një 65-70-vjeçar të mbajtur. Por, vetëm në pamje të parë. Në fakti



ishte tjetër njeri. Një 25-vjeçar. Brenda asaj koke punonte pashtershëm një tru elektronik. Brenda atij trupi buronte një energji djaloshare. Brenda atij burri mund të gjeje një fshatar tipik lab, me një të folme të pastër çobani, me një humor, ironi e sarkazëm bashkë, sa do t’i a kishte zili dhe aktori më i thekur. Por brenda asaj figure fshihej e shfaqej dhe një filozof, një arkitekt, një akademist, një ekonomist, një strateg i sprovuar betejash, një burrë i urtë. Ai në çast të shfaqej nga komandanti më i rreptë në një shok, aty tërsëllinte si bubullimë e në çast të vinte dorën në sup duke të thënë: “E a derëzi, qetësohu se s’ të vrava”. ... Grupi ynë pilot prej 22 studentësh që kishim fluturuar për një vit në Akademinë e Aviacionit, në Vlorë, me avionin mësimor Jak-91, kishim një javë që ishim vendosur në regjimentin e Farkës. Ne rreshtoheshim paksa veç regjimentit. Kjo sepse akoma nuk quheshim pilotë luftarakë. E pra një ditë para nesh u shfaq komandanti Lulo. Qëndroi me këmbë paksa të hapura, duke na hedhur një vështrim

të shpejtë secilit prej nesh dhe tha: “Hë djema, mirë jeni? A u sistemuat mirë me gjithçka? Hë mo flisni! Ju mungon gjë? Po këta komandantët që kemi caktuar të punojnë me ju, si ju duken? Ç’ të keni ma thoni këtu. Edhe për mua....Hë de, se nuk jeni kaq të urtë, mos më rrini si çupa...”, - pastaj iu kthye buzagaz Ndue Logut, i caktuar si komandanti ynë... “O Ndue! Sa do vuajmë me disa prej tyre... Djemaaa, mos ma vini re. Do bëjmë dhe shaka. Ju do bëheni pilotë shumë të mirë. Kur të mos jemi ne, ju do i vini shpatullat regjimentit, do kryeni detyra luftarake për Atdheun, për popullin. Por që të arrini deri atje duhet mendje e djersë e përkushtim”. - Pastaj na u afrua më pranë. Filloi të na pyeste....Mu drejtua dhe mua: “Po ty djalo, nga të kemi? Shijaku...? Ah, e kemi dhe një pilot të talentuar nga Shijaku. E nje Besnik Shahan? Bëhu si Besua që të nderoni Shijakun... Të jesh pilot do të thotë të jesh dhe trim dhe i mençur, dhe inxhinier dhe profesor, dhe i urtë dhe çakmak...”. Përballimi i dytë me komandantin Lulo ndodhi 7-8 muaj më

vonë. Fluturonim në aerodromin e Shtoit, në Shkodër. Kishim fluturuar rreth 20 orë program me instruktor. Isha përzgjedhur me tre apo katër shokë për të fluturuar me komandantin e regjimentit në fluturimin kontroll për të fluturuar vetëm. Të fluturoje me komandantin Lulo ishte jo vetëm emocion, por edhe ëndërr. Ëndrën po e prekja, por emocionin nuk e shmangja dot. Tek po mbërtheja rripat në kabinë e hapja çelësat e nevojshëm, komandanti kish vënë re emocionin tim. Me dorën e majtë më rregullon disa cullufe që më binin mbi ballë nga nënshlemafoni e me të djathtë shtypi butonin e bashkëbisedimit të brendshëm: “Jepi djalo, zëre se nuk jam fare këtu. Bëj ç’ di e ç’ të kanë mësuar. Unë ç’ kam qenë në Rinas, kurse këtu je ti usta!” ...Mblodhi këmbët duke i hequr nga pedalet dhe kryqëzoi duart mbi gjoks. Me këtë veprim donte të më thoshte se: “... ja, fluturimin po e realizon vetëm ti. Unë jam thjesht pasagjer”. U ngrita. Realizova dy fluturime në rreth. Patjetër që lejova dhe gabime. Fundja isha një kursant që aspiroja për t’u bërë pilot. E për të më promovuar në këtë mision ishte në kabinë pikërisht ky babaxhan, i cili jo vetëm që nuk preku asgjë, por as dhe nuk foli një fjalë. Vështronte jashtë e hera-herës hidhte vështrimin në paretin e instrumenteve e dorën time mbi dorezën e komandimit, duke buzëqeshur i kënaqur. Komunikova me radio vetëm më udhëheqësin e fluturimit, komandantin e skuadriljes, Ndue Logu. E prita komandantin, duke iu paraqitur me bllokun e vërejtjeve dhe librezën e fluturimit në dorë. “Të kam thënë që do t’i ngjash Besnik Shahes. Bravo! E nderove Shijakun. Mos e vrit mendjen për gabime të vogla. Je akoma i ri për të qenë perfekt. Dale-dale, ia futa kot. Fluturim perfekt nuk ka. Pilot i zoti është ai që e zbulon në kohë gabimin e bërë dhe e eliminon. Fluturimi është art, art i të mundurës. Pse artistët nuk bëjnë gabime? Por i kalojnë situatat aq bukur sa ne në sallë nuk kuptojmë gjë. Këto gjëra arrihen vetëm me punë, me disiplinë, me kërkesë ndaj vetes, me eksperiencë. Ju sot jeni djem me shkollë, jo si ne dikur. Ja unë, 14 vjeç partizan, pas lufte për tre vjet mbarova 7-vjeçaren dhe shkollën ‘Skënderbej’, pastaj andej nga stepat

ruse, shkolla e kurse...Do mësoja gjuhën, e me atë gjuhë do mësoja teorinë e fluturimit, teorinë e motorit, navigimin, rajonin e fluturimit, etj. Shqetësohesha shpesh, për gjakun e shokëve më zinte paniku, a do të arrija unë, një çoban e bir çobani, a do të arrija këtu në dhe’ të huaj të nderoja veten dhe Shqipërinë time të varfër e të dashur... Eh! Por, ç’ bëra. Erdha këtu, në mëmëdheun tim. Në Qytetin Stalin (Kuçovë), në Rinas, në Farkë. Gatishmëri e fluturime, ditën e natën, net pa gjumë...Eh. Ja shiheni! (hoqi kapelën e shkoi pëllëmbën mbi kokën e braktisur nga flokët). E pra jam 40 vjeç. As fëmijëri s’kalova si të tjerët, as rini jo se jo! (psherëtin përsëri)Ja, kam tri çupa, u rriten e s’i ula një herë në prehër... Sot brezi juaj ka më tepër shkolla e më pak telashe. Hajde çuna nëpër kabina. Boll ju përrallisa”. Ne kursantët, instruktorët dhe komanda, të mbledhur rreth tij në formë gjysmë rrethi, të mahnitur nga ligjëratat e sinqertë, tërësisht shoqërore e miqësore bashkë, e këtij burri të plakur para kohe në qiell, i cili foli me ne kursantët sikur kishte përpara shokët e vet më të ngushtë. Nuk lëvizti askush nga vendi me gjithë ‘urdrin’ e komandantit të madh, por vazhdonim ta shihnim me admirim tek nxori qesen e duhanit ‘Tarabosh’ e filloi të dredhë cigaren me gishtat e trashë. Më pas tek u ‘rrita’, krijova familje, fillova të thinjesha e të kaloja ditët e netët më tepër në repart se pranë familjes, tek jam përplasur me dallgët e qiellit e të jetës, i kam kujtuar me qindra herë ato fjalë e atë psherëtimë “... Eh, djema...”. Këtë psherëtimë e kam kujtuar dhe në kabinë të helikopterit pas 30 vjetësh tek vështroja kursantin tim që “vallëzonte” në varje. Nuk i flisja, nuk i ndërhyja, le të djersinte vetë... Kishte vite që ne, brezi i “aerodromit të Shkodrës” ishim bërë ‘baballarë’ të regjimentit. Kryenim detyra nga më të rëndësishmet, ditën e natën, madje dhe stërvitje bashkëvepruese me kolegët e NATO-s, ishim instruktorë prej kohësh... I madhi Lulo ishte i madh në çdo gjë. Në punë, në fluturim, në fantazi, në biseda, në kritika. Më vjen keq që nuk e kam librezën e parë të fluturimit. Pas përfundimit dhe mbushjes ato dorëzoheshin në sekretari. Sot do të isha i lumtur po të kisha atë ‘shkëlqyeshëm’ të shkruar me dorën e ‘Ujku të qiellit’, Lule Musai, me shkrim disi të deformuar, të shkruar në këmbë, aty në aerodromin e Shtoit, nga ku nisi rrugëtimi im 33-vjeçar në qiell...”

4 prilli, data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në NATO

GJENERAL BRIGADE (R)
PIRO AHMETAJ

Si ndër pjesëmarrësit teknik në datën që Republika e Shqipërisë u ul me të drejta të plota në tavolinën e 28 vendeve të NATO-s (Samiti i Köln/Strasbourg), sigurisht që e di fort mirë që data zyrtare e pranimit të Republikës së Shqipërisë është data 1 prill 2009!

Gjithsesi, në 14 vjet rresht, vijoj të insistoj për t'i "zhvendosur celebrimet protokollare nga data 1 në 4 prill", duke e bashkuar anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë me atë të themelimit të NATO-s (4 prill 1949/2009). Thënë kështu, shprej të adresohet/t si: "gjetje e mençur, pasi konfirmon një ngjarje të madhe, e cila i jep vlerë kësaj të vërtete historike për kombin".

Duke e parë kështu, data 4 prill 2023 shënon 14-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë si dhe përvjetorin e 74-ët të themelimit të Aleancës Ushtarake më të fuqishme të historisë së njerëzimit, e cila ka luajtur dhe vijon të mbajë peshe kritike për paqen, sigurinë, mbrojtjen e vlerave të demokracisë si dhe interesat gjeopolitike, jo vetëm në hapësirën Euroatlantike.

Kur 74 vjet më parë, "Babai-themelues dhe Komandanti i parë i NATO-s, Dwight D. Eisenhower, e projektoi Aleancën e Atlantikut të Veriut si një instrument politik - ushtarak për mbrojtjen e tërësisë territoriale (në rast sulmi nga kampi Stalinist. Ndoshta askush nuk e kishte imagjinuar se Gjenerali brilant kishte projektuar themelimin e Aleancës më të suksesshme të sigurisë globale.

Mbas 74 vjetësh, mund të thuhet me bindje se NATO e ka përbushur misionin në mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendeve anëtare, si dhe ka shërbyer si një mekanizëm shprese për paqen dhe sigurinë në botë.

Edhe pas viteve 1990, përveç misionit bazë NATO "ka dominuar tregun e mjedisit të Ri të sigurisë globale", nëpërmjet një procesi të gjithanshëm reformimi dhe modernizimi të konceptit strategjik, strukturave, armatimit, pajisjeve, planifikimit dhe kulturës së bashkëpunimit mes vendeve anëtare.

Një ndër shtyllat e këtij suksesi mbetet politika e "Dyerve të Hapura/Open Door Policy", që NATO e lançoi mbas viteve '90, e cila ka shërbyer edhe si mekanizëm për reformat e sigurisë dhe mbrojtjes dhe si shkollë e demokracisë për vendet e lindjes komuniste. Falë këtij mekanizmi, nga 16 vende para 1990 (për punë ditësh Finlanda), NATO përbëhet nga 31 anëtarë, ndërsa me firmosjen e ratifikimit nga Turqia të Marrëveshjes së Uashingtonit, me Suedinë, arrin në 32, ose dyfishin e vendeve që kishte në 1990-tën!

Në hapësirën Euroatlantike/NATO-s jeton një popullsi rreth 1 miliard banorë, zotëron më shumë se gjysmën e ekonomisë botërore, ndërsa personeli aktiv arrin në 3.5 milionë. SHBA, Franca dhe Anglia zotërojnë armë bërthamore, për misionin e shkurajimit (deterrence) të kundërshtarëve potencial.



Për fatin e kombit tonë, historia më e suksesshme e angazhimeve të NATO-s mbetet operacioni ushtarak në Kosovë (1999), që edhe pse jashtë artikullit 5, demonstroi fuqinë ushtarake të Aleancës si: "shpresë e paqes, të drejtave të njeriut dhe stabilitetit demokratik".

Do ishte e padrejtë, nëse në çdo 4 prill, të mos e përsërisim rolin jetik të SHBA-së në Aleancën e Atlantikut të Veriut, pasi ajo mban barrën kryesore të fuqisë dhe shpenzimeve ushtarake. Mjafton të përmendim shpenzimet e mbrojtjes rreth 1 trilion USD (për vitin 2023), ose mbi dy herë më shumë se 29 vendet e tjera të NATO-s të mara së bashku.

Shkurt, për qasjen e NATO-s ndaj kërcënimeve dhe sfidave aktuale. Agresioni ushtarak i Rusisë, nuk ishte, as është vetëm kundër sovranitetit të Ukrainës por edhe: "kërcënim serioz ndaj rendit global të sigurisë si dhe interesave të Aleancës Euroatlantike (USA/NATO)".

Ndërsa, Krimea, Bosnja, Kosova, etj., kanë treguar se kërcënimet ushtarake po sofistikohen nëpërmjet përdorimit të formave të reja, si referendimet e mbështetura nga jashtë, fundamentalizmit fetar, krimin të organizuar, axhendës së politikanëve të korruptuar, qeverisjet e dështuara, etj.

Në këto rrethana, përveç misionit madhor për mbrojtjen e tërësisë territoriale të 30/+2 vendeve anëtare, NATO-s i duhet të mbajë përsëri barrën kryesore. E pamundur për të ndaluar ambicet e Rusisë të "aneksimit të Krimesë me tanke dhe marrëveshje+", prej vitit 2014, NATO ka dislokuar Forca të Gatishmërisë Shumë të Lartë në vendet Baltike, Europën Qendrore dhe Juglindore.

Mbas 13 muajsh luftime, mund

të themi se Rusia-Putiniste i ka (keq) humbur betejat, për të testuar kohezionin mes vendeve të NATO-s, qoftë edhe duke kërcënuar me gazin, si armë gjeopolitike si dhe me përdorimin e fuqisë bërthamore. Në të kundërt, rreth 100 miliardë € armatim dhe pajisje ushtarake moderne, përfshi Tanke "Leopard", sistemet "Patriot", etj., janë prova të forta për kohezionin dhe vendosmërinë e përfuruar të Aleancës Transatlantike, për ta mbështetur Ukrainën deri në fitoren ndaj të keqes së përbashkët.

Rusia gjendet më e izoluar se kurrë nga bota e qytetëruar: "nga 193 vetëm 4 shtete terroriste e njohën këtë aventurë neo-naziste"; rrezikon seriozisht përjashtimin nga 5-shja vendimmarrëse e Këshillit të Sigurimit/OKB dhe besoj, jo shumë vonë, Putini dhe gjeneralët gjakatarë do të përgjigjen për krime kundër njerëzimit në Gjykatën e Hagës.

Përkundër panikut dhe (del) elokuencës së analistëve të gjithë-ditur dhe strategëve të vetë(de)graduuar, përsëris bindjen strategjike se: "falë rezistencës stoike të Ukrainës dhe vendosmërisë së NATO-s, Rusia - Putiniste do ta humbasë me turp luftën, si dhe do të gjuhëzohet në përbashkëtim me fuqinë ushtarake, kohezionin e përfuruar dhe interesat gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike (SHBA/NATO)!

Për shkak se ushtarët dhe mjekët duhet të marrin vendime në situata me stres të lartë, AI-ja është në gjendje t'i ndihmojë ata kur një anëtar i shërbimit mund të ketë nevojë për ndihmë. Ky lloj i AI-së përdor një algoritëm dhe një bazë të dhënash të madhe mjekësore që është në gjendje të aksesojë të dhënat që përmbajnë raste të traumave mjekësore, të cilat përfshijnë diagnoza, grupe shenjash vitale, medikamente të dhëna, trajtime dhe rezultate. Më pas merr këto të dhëna, të kombinuara me informacionin e futur manualisht për të dhënë indikacione, paralajmërimet dhe sugjerime për trajtim. Kjo është një situatë tjetër në të cilën AI-ja ka nevojë për udhëzim njerëzor në mënyrë që të funksionojë në mënyrë efektive; ndërsa AI do të bëjë rekomandime pa konsiderata emocionale si pengesë, njerëzit duhet të përdorin aftësitë e tyre emocionale për të marrë vendime të përshtatshme që marrin parasysh këto rekomandime. Inteligjenca artificiale nuk është e kualifikuar për të marrë vendime mjekësore, por mund të sigurojë analiza të shpejta për t'u dhënë njerëzve më shumë informacion mbi të cilin mund të bazojnë vendimet e tyre.

E zbatuar me përpikëri, AI-ja më moderne mund të përmirësojë funksionimin e shumë aspekteve të operacioneve ushtarake. Rritja e produktivitetit, zvogëlimi i nevojës për kontribut njerëzor dhe rritja e efikasitetit janë vetëm disa nga fushat ku AI mund të mbështesë forcat e armatosura.

Kukësi, "aty ku Zoti dhe natyra bëhen bashkë"

Kukësi, i vendosur në pjesën verilindore të vendit, është qyteti simbol i mikpritjes shqiptare. Qyteti i Kukësit shtrihet në rrëzë të Malit të Gjallicës dhe në breg të Liqenit të Fierzës, në Rrafshen e Lumës.

Historia e Kukësit nuk fillon me krijimin e Kukësit të ri. Historia e Kukësit daton para një mijëvjeçari, sipas zbulimeve arkeologjike të gjetura në zona të ndryshme të qarkut të Kukësit.

Emri i Kukësit mendohet se lidhet me familjen feudale të Kukajve, ku njëri nga bijtë e tij ka qenë komandant në ushtrinë e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit - Skënderbeu. Kjo familje për herë të parë përmendet në regjistrin Osman të vitit 1571. Por më afër variantit të saktë për toponimin Kukës, mendohet se qëndron fjala latine Quercus (kurkus), që sot shqiptohet Kukës dhe që në shqip përkthehet me fjalën bungajë. Në të vërtetë gropa e Kukësit ka qenë një bungajë.

Fillimisht, zona ku ndodhet sot qyteti ishte shtëpia e disa fiseve të lashta ilire, ku janë zbuluar shumë varre ilire. Vetë qyteti shtrihet në një rrugë që degëzon nga Via Egnatia, rrugë romake e shekullit të II, që lidhte Romën me atë që dikur quhej ana evropiane e Turqisë.

Mortaja e vitit 1689 shoi shumë vendbanime. Kjo bëri që zona të braktisej për gati një shekull, derisa në gjysmën e parë të shekullit të VIII u ripopullua nga vëllezërit Elezaj, Zenel-Liman, Adem-Dulla, Ali-Hasa, që u shpërngulën nga fshatrat e Bicajve. Nga mesi i shekullit të XVIII ato u vendosën përfundimisht në gropën ndërmjet Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, duke rikrijuar vendbanimin e Kukësit.

Kukësi mund ta shohim në tre dimensione. I pari është Kukësi i vjetër, i cili përmyt nga ujërat e liqenit të Fierzës në vitin 1978, i dyti është qyteti i sotëm, Kukësi i Ri, i treti dhe më misteriozi, përfshin një rrjet tunelesh labirint, të ndërtuar nën Kukësin e sotëm gjatë regjimit komunist.

Kukësi i Vjetër

Kukësi i vjetër, apo siç e quanin dikur "Stambolli i vogël", ka qenë një pikë takimi e kryqëzimit rrugësh që në lashtësi. Shtrihet në rrafshin ku sot ndodhet liqeni i Kukësit, aty ku



bashkohet Drini i Bardhë me Drinin e Zi. Por, tashmë nga ajo madhështi që ka qenë dikur kanë mbetur vetëm rrënojat, të cilat herë pas herë, në periudha thatësire, shfaqen si për t'i kujtuar ata që e kanë jetuar, e për t'i sjellë në mend historinë e të parëve e lavdinë e qytetit të vjetër.

Në vitet 1912-1921, Kukësi u pushtua nga serbët, bullgarët dhe austriakët. Mori pjesë në luftërat kundër forcave serbe në vitet 1912-1913, ku shumë banorë të tij u masakruan si pasojë e sulmeve serbe. Në vitin 1921 deputeti i parë i Kukësit zgjidhet Mustafë Lita. Në vitin 1923 u bë qendër krahinore me 28 shtëpi e 186 banorë. Në gusht 1925, shpallet qendër e Prefekturës duke zëvendësuar Krumën e Hasit. Në këtë periudhë, popullsia e Kukësit shtohet në mënyrë të konsiderueshme me ardhjen e qindra familjeve nga Gjakova dhe Prizreni. Ata sjellin me vete tregtinë dhe tradita të reja gatimi e shërbimi, e shumë zeje. Gjatë kësaj kohe vijnë dhe shumë familje nga Gora. Në fillimin e viteve '30 Kukësi shpallet bashki.

Në vitin 1935 qyteti gjallërohet nga institucionet shtetërore, shkolla, shoqëria sportive "Kosova", banda muzikore, enti kulturor "Djelmnia shqiptare", një rrjet shërbimesh publike dhe pazari i së dielës. Në mes të qytetit ngrihet ndërtesa e Prefekturës. Në kohën e mbretërisë shqiptare qyteti u lidh me rrugë automobilistike me Prizrenin në vitin 1935, me Bicajt në vitin 1936, me Shkodrën në vitin 1938. Pikërisht kjo lidhje me rrugë automobilistike bëri që numri i banorëve të qytetit të dhjetëfishohej. 14 prill 1939 pushtohet nga Italia Fashiste. 18 nëntor 1944, forcat gjermane largohen nga qyteti dhe hyjnë forcat partizane të Brigadës XVIII sulmuese. Në dhjetor 1944 vendoset administrata e re e Prefekturës. Rindërtohet ura mbi Drinin e Zi. Rihapet tregu, hapet Shtëpia e Rinisë, fillon punën spitali civil. Në vitin 1946, qyteti furnizohet me energji elektrike. Lidhet me rrugë automobilistike me Peshkopinë, hapen shkolla unike dhe konvikti. Krijohen ndërmarrja tregtare dhe kooperativat artizanat, konsum dhe shitblerje. Në vitin 1949, krijohet dega e Bankës Shtetërore.

Në periudhën 1950-1960 rritet ndjeshëm popullsia me banorë



të ardhur nga fshatrat, hapet Shtëpia e Kulturës, fillon punën kinemaja, hapet gjimnazi, ndërtohet ujësjellësi, krijohet estrada profesioniste, ngrihet Radio Kukësi dhe hapet shkolla pedagogjike 2-vjeçare. Fillon punën biblioteka e qytetit, dhe ngrihen Muzeu lokal dhe teatri i kukullave.

Më 31 mars 1962, u vendos përmytja e Kukësit të Vjetër dhe ndërtimi i Kukësit të Ri. Më 22 korrik 1962 filluan punimet për ndërtimin e Kukësit të ri. Fillon jeta paralele e dy qyteteve. Në vitin 1970 Kukësi kishte 6073 banorë. Në vitin 1978 Kukësi i Vjetër përmyt nga ujërat e liqenit të Fierzës.

Kukësi i Ri

Më vitin 1978, e tërë popullsia vendoset në qytetin e ri. Përurohen dy urat e mëdha mbi Drinin e Zi dhe Drinin e Bardhë, që do të lidhnin qytetin e Kukësit të Ri me Tiranën dhe Hasin.

Në dhjetor 1990, shqiptarët të nxitur nga ngjarjet në Evropën Lindore por edhe nga gjendja e vështirë dhe e izoluar në të cilën ndodhej vendi, filluan demonstrata antikomuniste në gjithë vendin.

Në 11-12 mars 1997, banditë të armatosur sulmojnë depot e



armatimit të ushtrisë në rrethinat e Kukësit dhe repartet ushtarake nëpër fshatra. Qyteti mbushet me njerëz të armatosur, duke shtyrë qytetarët e Kukësit të armatosen për vetëmbrojtje. Më 12 mars 1997 përhapet lajmi se ushtria serbe po përparonte drejt Kukësit, që çoi në largimin e shumicës së popullsisë së qytetit, përveç një pjesë të vogël që qëndruan për mbrojtjen e qytetit. Në vitin 1999, Kukësi pret afro 450 000 shqiptarë nga Kosova të dëbuar nga ushtria dhe paraushtarakët serbë. Kukësi përjeton periudhën më të vështirë në historinë e tij, duke u përballur dhe me bombardimet serbe në kodrat përreth qytetit. Në vitin 2000 kandidohet për Çmimin Nobel për paqe, duke u bërë i pari qytet në botë i kandiduar për një çmim të tillë.

Kukësi i nëndheshëm

Ky qytet i nëndheshëm ishte menduar të ishte një kopje e qytetit të Kukësit, 30 metra nën qytetin e vërtetë. Planet e para,



ishin për një seri bunkerësh. Në vitet 80 më pas u shtuan më shumë tunele dhe dhoma në projektin nëntokësor, përfshirë një hapësirë për një sallë shtypi, një spital dhe një mini-fabrikë buke. Më pas u shtua energjia elektrike dhe rrjeti i ujit të pijshëm. Atje duhej të kishte edhe një qendër komande të ushtrisë, një pikë policie dhe një sallë gjyqi. Ideja ishte që 10 mijë njerëz të mund të jetonin nën tokë pa u munguar asgjë për të paktën gjashtë muaj. Punimet e Kukësit të nëndheshëm përfunduan në 1989, por para se i gjithë rrjeti të pajisej për funksionim të rregullt, regjimi ra.

Ky qytet i nëndheshëm, ku mund të strehoheshin më shumë se 30 mijë persona nga sulmet e armiqve të atëhershëm të socializmit, do të kthehet tashmë në një atraksion turistik për vizitorët vendas e të huaj. Kjo do të ndodhë përmes projektit "Adrion" të Bashkimit Evropian, i cili do të rivitalizojë "Kukësin e nëndheshëm", dhe synohet të japë kontribut jo vetëm në njohjen e vlerave dhe aseteve të qytetit të Kukësit, por dhe ekonomisë së këtij qyteti.

Kukësi ka potenciale për të qenë një nga vendet më të zhvilluara turistike në Shqipëri, pasi ka të gjithë larinë e elementëve turistikë si: relievin e shumëllojshëm, ujin e bollshëm liqenor-lumor dhe burimor, klimën dhe mikroklimat, malet, pyjet, liqenin, lumenjtë, burimet dhe gurrat, livadhet alpine, bjeshkët me pishnajë dhe ahishte, monumentet e natyrës, kushtet tërheqëse për ushtrimin e llojeve të ndryshme të sportit si në futboll, mundje, hipizëm, rrëshqitje me ski, gjuetinë e peshkut, të zogjve dhe të kafshëve të egra etj.

Liqeni i Kukësit

Liqeni i Kukësit shtrihet përgjatë rrjedhës së Drinit të Bashkuar (Drini i Bardhë e Drini i Zi), deri në qytetin e Kukësit dhe vijon në rrjedhën e Drinit të Bardhë deri në Nashec të Prizrenit e në rrjedhën e Drinit të Zi deri afër Skavicës së Kukësit.

Ky liqen u krijua në vitin 1976 në funksion të hidrocentralit më të madh të Shqipërisë, ujëmbledhësi i Fierzës ose, siç quhet nga banorët, Liqeni i Kukësit, duke përmytur kështu qytetin e Kukësit të vjetër. Ka një sipërfaqe prej 72,5 km², ku pjesa më e madhe shtrihet në territorin e Shqipërisë dhe një pjesë e vogël në Kosovë. Niveli i ujërave është 270 metër mbi nivelin e detit. Thellësia maksimale e tij është 128 metra.

Liqeni i Kukësit e rrethon nga tri anët qytetin dhe mbetet i lidhur vetëm në njërin anë me Malin e Gjallicës, duke krijuar një pamje mahnitëse, mes malit e liqenit.

Ky liqen është i lundrueshëm në pothuajse të gjithë sipërfaqen e tij, është një bukuri e pakrahasueshme.



Lundrimi apo shëtitja turistike nëpër luginën e Drinit, mes shpateve e grykave do të ishte një eksperiencë e paharrueshme.

Lundrimi ka shërbyer, dhe shërben ende në disa raste, për të lidhur fshatra të shumta bregliqenore të Kukësit, Pukës e Tropojës. Vite më parë, nëpërmjet anijeve të vogla, banorët e këtyre zonave kanë sjellë në tregun e qytetit prodhimet e tyre bujqësore e blegtorale, drutë e zjarrit, bagëtisë për shitje etj.

Liqeni i Fierzës është i pasur me peshq të llojeve të ndryshme. Shumë i preferuar është peshku i Luçiperkës, peshq që rritet vetëm në këtë liqen, si dhe ballëgjieri, gjuhca e krapit, që u hodhën si rasat dhe gjetën një mjedis shumë të përshtatshëm për t'u shumuar e ushqyer. Krijimi i liqenit solli dhe zhdukjen e peshqve që më parë popullonin lumin Drin si trofta, ngjala e peshq të ujërave të rrjedhshëm, por favorizoi rritjen e peshqve të liqeneve. Gjitarët uxorë që jetojnë në ujërat e Liqenit të Fierzës, janë lundërzat. Gjithashtu krijimi i liqenit, bëri të mundur dhe rritjen e midhjeve të vogla të ujërave të ëmbla. Peshku më i madh që është kapur në Liqenin e Kukësit, në vitin 2004 ka peshuar 64 kilogram.



Vitet e fundit, për shkak të ndryshimeve klimatike dhe mungesës së reshjeve, herë pas here niveli i liqenit bie në kuota aq të ulëta sa mund të shquhen rrënojat e ndërtesave të Kukësit të vjetër.

Mali i Gjallicës

Një nga malet më mahnitës në Shqipëri, Mali i Gjallicës, 2489m mbi nivelin e detit, është mali më i lartë në rrethin e Kukësit. Me një pamje madhështore shfaqet përballë qytetit të Kukësit, duke plotësuar mozaikun shumëngjyrësh të peizazhit natyror që Zoti i ka falur këtij vendi.



Nga maja e Gjallicës, siç e kanë quajtur me të drejtë Ballkonin e Veriut, sheh jo vetëm qytetin e Kukësit, por mund të shohësh gati çdo majë që ndodhet në pjesën veriore të Shqipërisë, Kosovës apo Maqedonisë, Lumin e Drinit të Zi që vjen nga Tetova dhe Lumin e Drinit të Bardhë që vjen nga Prizreni. Mali i Gjallicës dhe i Koritnikut mbajnë në vete shumë bukuri natyrore, me peizazhe mahnitëse, të cilat mund të vizitohen në të gjitha periudhat e vitit e në secilën prej këtyre vizitave mund të merrni një eksperiencë të ndryshme dhe kënaqësi të papërsëritshme.

Gjatë ngjitjes për në Majën e Gjallicës, do të ju duhet të ndaleni shpesh për të soditur bukuritë e natyrës që të përcjellin në rrugëtim.

“Gryka e Vanave”

Gryka e Vanave është një grykë e thellë mes Malit të Gjallicës dhe Malit Koritnik, e krijuar nga gërryerja e shkëmbinjve nga lumi. Gryka është shumë e thepisur me shpatë që ngrihen mbi shtratin e lumit dhe ujin e kristaltë që rrjedh, duke formuar ujëvara përgjatë rrjedhës.

Liçeni i Kallabakut, Nevoje

Ky liçen i bukur, me sipërfaqen e tij të qelqtë dhe spektrin e ngjyrave të natyrës së egër, shfaq disa nga cilësitë më magjepsëse të ujit. E veçanta e këtij liçeni është se të servir pamje unike në të gjitha stinët e vitit.



Liçeni i Kallabakut ose i Novosejit, është një ujëmbledhës artificial me sipërfaqe ujore rreth 7 hektarë dhe thellësi maksimale rreth 16 metra.

Shtegu i ngjyrave

Disa nga atraksionet kryesore në Kukës burojnë nga historia e tij unike dhe vendndodhja e tij befasuese.

Shtegu i Ngjyrave, pjesë e parkut natyror Korab-Koritnik, i cili fillon nga Shishtavecit deri në Çajë dhe është 13 km i gjatë, është kthyer në një nga destinacionet më të frekuentuara nga turistët shqiptarë e të huaj.

Pamjet e magjishme të lëndinave e blerta, që duken sikur s'kanë fund, qëndisur me lulet shumëngjyrëshe e plot aromë, prej të cilave ky vend ka marrë emrin, janë imazhet që kanë bërë një nga zonat malore më të vizituara nga turistët e apasionuar pas natyrës.



Po të jeni me fat do të shijoni edhe pamjet me tufat e kuajve të egër që vrapojnë mes lëndinave, duken si pamjet që kemi parë vetëm nëpër filma e dokumentarë. Në Shtegun e Ngjyrave përveç shetitjeve në natyrë mund të zhvillohen disa edhe lloje sporti si Mountine Bike, Hiking, etj.

E gjithë rruga që përshkohet drejt Shtegut të Ngjyrave është e mrekullueshme, ku gjatë dimrit formon edhe pista të përshtatshme për sportin e skive, ndërsa në pranverë-verë mbushet me lule, e në vjeshtë lugina pushtohet nga ngjyrat e arta të stinës.

Të tjera atraksione në Zonën e Kukësit janë edhe Ujëvara në fshatin Bele, Guri i Mëngjesit, fshati i Shishtavecit, etj...

Muzeu Etnografik i Kukësit

Pozicioni gjeografik dhe bukuritë natyrore, janë ato që e identifikojnë Kukësin. Sidoqoftë, mbropa nuk mbetet edhe historia, kultura dhe tradita e pasur. Për të vizituar zonën, me vlerë do të ishte edhe Muzeu Etnografik i qytetit, i cili sjell një përmbledhje gjithëpërfshirëse të pothuaj të gjithë informacioneve rreth etnografisë, arkeologjisë, biodiversitetit etj.

I pozicionuar në qendër të qytetit, Muzeu është i ndarë në tre pavijone: Biodiversiteti, Arkeologjia dhe Etnografia.

Pavijoni i Biodiversitetit

Kushtet klimatike të zonës e bëjnë këtë vend me një ekosistem të pasur që është i dokumentuar mirë me katalogët fotografikë të këtij pavijoni. Shumëllojshmëria e tulipanëve në Kukës është më e pasura në vend. Në Kukës gjenden më shumë se 750 lloje bimësh medicinale, 80 prej të cilave prodhohen e mblidhen nga fermerët vendas. Sherbela, duhani i egër, dollia e zezë dhe salepi, janë vetëm disa prej tyre. Përveç pasurisë së florës dhe faunës, Kukësi njihet dhe për pasuritë natyrore. Disa nga burimet natyrore më të vlerësuara të rajonit janë kromi, bakri dhe uranumi.

Pavijoni Arkeologjik

Në pavijonin arkeologjik ju do të njiheni mbi ekzistencën e qytetërimit kuksian, i cili daton që para 6000 vjetësh, para lindjes së Krishtit. Në zonën e Kolshit janë gjetur gjurmë që e dëshmojnë këtë fakt. Shfaqja e tumave ilire (kodërvarreve), në periudhën e bronzit, dëshmojnë gjithashtu për ekzistencën e Kukësit në antikitet. Shumë nga këto objekte gjenden edhe në Institutin Arkeologjik të Tiranës.

Zbulimet arkeologjike në vendbanimin neolitik të Kolshit, tumat e Kënetës, ato të Qinamakut, Bardhocit, Krumës, Përbregut, Myçhasit, gjetjet e rastit të Gostilit, Pusit të Thatë, Shtiqnit, vendbanimi shpellor i Dajçit, Gradishta e Bardhocit dëshmojnë për vendbanime të pandërprera të kësaj hapësire që nga neoliti e deri në ditët e sotme. Studimet historike dhe gjetjet arkeologjike thonë se në territorin e Kukësit ka jetuar fisi ilir i Sikulotëve.

Kështjella e Bushatit, Kështjella e Domajve, Keshtjella e Pecës, Kështjella e Shëmrisë, Kështjella e Çepës, Vendbanimi i Morinit, Kështjella e Mlikës, Vendbanimi i Mholes, Bicaj, janë vendbanime të tjera të zbuluara në zonën e Kukësit.

Pavijoni Etnografik

Të ecësh në këtë pavijon do të ndihesh sikur po udhëton në vend, e kohë tjetër. Një nga simbolikat e veshjes më të vjetër, është me punim mitani, i cili i përket zonës së Lumës dhe mendohet që është veshje mesjetare. Interesante për t'u vizituar është edhe oda e grave dhe e burrave të kompletuara me dekorime karakteristike.

Artizanati

Izolimi i hershëm i Kukësit nga pjesa tjetër e Shqipërisë për mungesë të infrastrukturës rrugore, ka ndikuar pozitivisht në ruajtjen e traditave të artit popullor, që vjen pothuajse e



pandryshuar deri në ditët tona.

Që në kohët e moçme endja në vegjë e pëlhurave prej liri, pambuku e leshi, punimet me grep, qëndisje, prodhimi dhe dekorimi i veshjeve popullore, kanë qenë profesionit i vetëm për gratë dhe vajzat e kësaj zone. Shumë e lashtë tradita e punimit të leshit në avlëmend.

Janë karakteristike dhe të lashta, motivet popullore që përdoren në prodhimin e qilimave dhe sixhadeve, me kombinime shumëngjyrëshe, me shije të hollë artistike, të cilat nuk mund të gjenden në asnjë zonë tjetër në Shqipëri.

Në vitet 1963, në Kukës filloi të funksiononte një ndërmarrje artizanati e madhe, e cila kishte 1000 punëtorë në qytet dhe 200 në fshatin Bicaj. Kjo ndërmarrje punonte kryesisht për eksport në Perëndim. Artikujt që prodhonte ishin sixhade, qilima, punime artistike me kashtë, thupra shelgu e tjerë. Në vitet '50 të shekullit të kaluar qilimat dhe sixhadet e punuara nga gratë e Lumës kanë prezantuar me dinjitet Shqipërinë në panairt e Europës, në të cilat janë vlerësuar edhe me çmime prestigjioze.

Në fillim të viteve 1990, ndërmarrjet artistike u mbyllën dhe zejtaria e humbi shkëlqimin e dikurshëm si profesion. Vetëm

pak mjeshtre vazhdojnë të mbajnë traditën gjallë dhe punojnë në shtëpitë e tyre, ku prodhojnë qilima dhe sixhade, veshje popullore dhe punime të tjera dore, duke ruajtur traditën në motivet e hershme, por edhe duke e pasuruar atë me motive të reja në përputhje me trendet e kohës dhe kërkesat e tregut.

Prodhimet e artizanatit të sotëm kuksian, janë në vazhden e traditave shekullore që datojnë nga koha ilire. Por ka edhe zanate të tjera të cilat janë zhdukur me kalimin e kohës, si tradita e poçerisë. Vetëm disa dekada më parë, në varret e zbuluara gjatë kërkimeve arkeologjike, në fshatin Kolsh, në afërsi të Kukësit, janë gjetur objekte poçerie, të zbuluara me vizatime artistike, e të prodhuara nga vendasit.

Edhe gdhendja e gurit, drurit, punimi i hekurit kanë qenë përdorur gjerësisht dikur për zbulimin e shtëpive, duke filluar që nga periudha e mesjetës e në vazhdim. Por edhe këto janë profesione që po harrohen.

Punëdoret e grave janë ato që më së shumti i kanë rezistuar kohës deri në ditët e sotme. Një vend të rëndësishëm në punëdoret, përveç qilimave e sixhadeve, zë edhe përgatitja e kostumeve tradicionale popullore të grave dhe burrave. Ato janë ruajtur origjinale dhe janë një shprehje e qartë e identitetit kuksian.

Veshjet tradicionale

“Veshja popullore shqiptare është më e bukura në botë”,



Bajron, 1809

Kostumet popullore, sidomos të grave, shquhen për bukurinë, elegancën, koloritin e pasur dhe shumëllojshmërinë. Ato janë unike në llojin e tyre. Larmia e kostumeve të grave është aq e madhe sa brenda rrethit të Kukësit, ato ndryshojnë tërësisht nga njëra-tjetra.

Në trashëgiminë kulturore të Bashkisë së Kukësit përfshihen tre krahina etnografike: Luma, Gora dhe Malziu, të cilat njihen për elemente të spikatura, për sa u takon veçorive të veshjeve tradicionale. Kështu, dallohet veshja me mbështjellëse e Lumës (veshja e bardhë); veshja e Gorës me mbështjellëse; veshja e Malziut, e cila ka një ngjashmëri të dukshme me veshjen e gjanë të Tropojës por ka një punim më të thjeshtë për sa i përket dekorimit të saj. Karakteristike për burrat, është veshja me tirçe, që janë të gjitha të punuara nga shajaku, kanë më shumë elemente të përbashkët, duke ndryshuar vetëm në mënyrën e veshjes dhe dekorimit. Veshja e Arnit mendohet se është veshja më e hershme në kohë, se veshjet e tjera të përdorura në Kukës.

Kostumet tradicionale të femrave ndryshojnë pothuaj tërësisht sipas zonave, ku dallojnë: kostumi i zonës së Shëmrisë; kostumi i zonës së Lumës; kostumi i Bushtricës; kostumi i Shishtavecit; kostumi i Hasit; kostumi i malësisë së Tropojës; kostumi i zonës së Lekbibajit.

Në Tropojë larmia më e madhe ekziston të veshjet e grave. Tiparet kryesore janë: Veshja e “ngushtë” dhe veshjet me “pëstjellak te gjanë”. Veshjet popullore të Hasit janë trashëguese e transmetuese të shumë elementëve, që vijnë nga lashtësia. Veshja tradicionale e Rekës, sipas etnografëve, është ndër më të veçantat në Europë dhe Ballkan dhe dallon për dekorin asimetrik, të pa hasur në zona të tjera dhe dekorohet me elementë tepër të veçantë dhe që dallojnë nga të gjitha trevat mbarë shqiptare. Sot këto kostume shpalosen me gjithë bukurinë e tyre vetëm gjatë festivaleve folklorike, festimeve të tjera popullore, apo dasmave. Kostumi tradicional konsiderohet nga populli si një element identiteti që e dallon nga krahinat e tjera të Shqipërisë.

Këngët e vallet: Këngët interpretohen me çifteli, lahutë dhe fyell. Kërcimet interpretohen kryesisht me lodra, curle, gajde dhe çifteli.

Vallja e Kukësit, të cilën e kërcejnë dhe e adhurojnë shumica e shqiptarëve, ka si karakteristikë ritmin në rritje, lojën perfekte dhe shkathësinë e lëvizjeve të interpretuesve. Vallet e Lumës, në përgjithësi shquhen për dinamizmin e tyre dhe brendinë artistike. Mjafton të kujtojmë “Vallen e Shtatave” të pleqve të Kukësit apo “Kalloçojë”, “Vallen e Thuprës”, “Vallen e Kaçakut”, “Vallen e Kosave” etj. Si rrallëkund, te vallja e Krahinës së Lumës, janë gërshtuar të gjithë zhanret e artit; loja koreografike, aktrimi, kënga.

Kuzhina tradicionale

Pozicioni gjeografik, si një zonë malore me klimë të ftohtë e të ashpër gjatë dimrit, ka ndikuar edhe në karakteristikat dhe llojet e ushqimeve që konsumohen, të cilat janë të plota e të rënda.

Flija Kuksiane plot gjalpë e pjekur në saç (me miell gruri ose misri), e cila është edhe një nga ushqimet më karakteristike të Kukësit, petë misri, petulla në vaj, bukë kollomoqi (bukë misri), sarma, etj.

Mishi i thatë (pastërma), turshitë e larmishme, mjaltë gështenje dhe troftë alpine, peshku luçiperkë i liqenit të Kukësit, raki të shumëllojshme etj. Qengj me tamël, në Kukës, Tropojë dhe Prizren është një recetë e vjetër dhe e thjeshtë, por me një shije fantastike.

Kukësi ndërthur kaq bukur të gjithë elementët turistikë, duke shtuar në veçanti elementin njerëzor. Janë cilësitë e rralla që i karakterizojnë kuksianët, cilësitë tipike shqiptare si Besa, Bujaria, Trimëria, Mikpritja, të cilat gërshetohen kaq bukur me pamjet piktoreske të natyrës, që do të bënte për vete çdo vizitor.

Punoi: Suela Hoda

Dëshmorët e Atdheut, dëshmia historike e frymëzimit në breza

“Dëshmorët e Atdheut”, kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha ranë në krye të detyrës shtatë vite më parë, si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC -145 në Malësinë e Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor.

Prilli i para 7 viteve u ndal në gjysmë, pranverën e re nuk do e shijonin më dy djemtë e rinj, ‘shqiponjat e qiellit’, Floriani dhe Donaldi.


Sot dhe përgjithmonë ne do kujtojmë dëshmorët tanë, inspirimin e brezave në vite.

Dëshmorët janë ndërgjegjja më sublimë dhe vetëdija e ngritur lart, deri në pedestalin e vetëflijimit. Breza të tërë pas nesh do i kujtojnë ata!

Dëshmorëve u këndohen këngë trimërie, si këto fjalë zemre që në vijë melodike vijnë për dëshmorët tanë:



Nga Trupi po prapë
Shfaqet një ylber
Flamur kuq e zi valëvitet në erë
Është komandant Hoxha
Mbi helikopter
Legjendë e vendit
Do mbetesh përherë
Aty në ballkon ka mbetur nëna
Me buzët që dridhen për djalin e saja.
Me mision u nise për të fundit herë
Bashkë me Florianin ju mbetët në qiell
Ata që të njohin të kujtojnë me mall
Dëshmorët e atdheut, përjetë jeni gjallë
Një shembull i ndritur
Për brezat që vijnë
Atdheut që deshët ja rritët lavdinë.



Kujtimet e vetme që kemi për dëshmorët janë përmendoret, lapidarët, dhe kujtesa historike që na bën të jemi krenarë.
I përjetshëm kujtimi i bijve tanë!

Indrit Cara, “yll i pashuar” i trojeve shqiptare

Indrit Lulzim Cara, “Dëshmor i Kombit”, lindi në qytetin e Kavajës, më 11 korrik të vitit 1971, në moshën 14-vjeçare regjistrohet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë, e cila ishte fidanishtja e kuadrove të ushtrisë shqiptare. Pasi kryen këtë shkollë dërgohet të përgatitet për oficer kundërajror në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”. Pas dy vjetësh studime në atë akademi, në Shqipëri fillojnë proceset demokratike. Duke i parë qartë se si do të rridhnin ngjarjet, Indriti largohet nga shkolla në vitin e fundit, kthehet në familje dhe pasi merr edhe miratimin e saj për atë vendim, shkon refugjat ekonomik në Itali, ku qëndron dy vjet. Më vonë kalon në Londër, ku merr edhe vëllain tjetër, Dorjanin. Morën kurbetin, si gjithë rinia shqiptare, pasi e panë qartë se prindërit ishin të moshuar, pa shtëpi, pa punë dhe pa perspektivë edhe për ata.

Në Londër, Indriti takohet, punon e jeton edhe me shumë djem nga Kosova. Miqësohet me ta. Në Kosovë më në fund del në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Gazeta “Zëri i Kosovës” jepte gjithnjë e më shumë lajme për luftën në Kosovë. Kjo e entuziazmon Indritin. U bë më i gjallë, më shprehës, më i gëzuar... Më 18 dhjetor 1997, Indriti boton një shkrim në gazetën e UÇK-së. Ai u bën thirrje të gjithëve që e ndjenin veten sado pak shqiptarë, të ndihmonin luftën me të gjitha format. “Ta ndihmojmë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, këtë filiz shprehe, force dhe krenarie, që të rritet e të forcohet si një lis madhështor, t’i bëjë ballë shtrengatës serbe. Rroftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, mbyllet shkrimi i Indritit. Pra qysh në fillimet e saj, Indriti e ndjek në vijimësi situatën e luftës në Kosovë dhe në janar të vitit 1999 lë Londrën dhe nis për në Shqipëri, me vendimin se do të shkonte të luftonte në Kosovë, në radhët e UÇK-së. Pasi mbërrin te prindërit e tij, pas 8 vjetësh ndarje, (tani i gjen në banesën që ai u kish blerë), ndahet shpejt prej tyre dhe nis në Kosovë, bashkë me tre shokët e tij prej Kosove, që kishin qenë së bashku në emigracion.

Bëjnë tentativën e parë përmes Kukësit. I ndalon policia shqiptare, i arreston dhe i kthen në Tiranë. Dalin nga burgu me ndërhyrjen e ambasadorit



shqiptar në Londër dhe nisen përsëri për në luftë. Fillim i marsit 1999. U desh të kalonin fshehtas liqenin e Fierzës dhe të mbërrin në Pagarushë, Neshec. Ato ditë pritej fillimi i një ofensive e ushtrisë serbe kundër zonës së Pashtrikut.

Ishte 31 mars 1999. Kish më se një javë që zona e Pashtrikut zhvillonte luftime të ashpra me ushtrinë serbe. Sulme e kundërsulme të përditshme. Armiku çdo ditë e më shumë po sillte përforsime si në forca, ashtu edhe në mjete zjarri. Nga të dy anët kish humbje të konsiderueshme. Komandanti i Zonës së Pashtrikut, Tahir Sinani, i cili kishte organizuar zbatimin e vendimit për mbrojtje aktive dhe të mos e lëshonte zonën e Pagarushës, sikundër ishte urdhri nga Shtabi i Përgjithshëm, për mbrojtjen e popullatës së grumbulluar në atë zonë, ku ishin me dhjetëra mijëra gra, pleq e fëmijë, sjell këto kujtime nga Indriti: “Në drejtim të Samadrazhës armiku mundi të depërtonte me tanke, përgjatë luginës. Nevojiteshin përforsime për të dhënë kundërsulm. Nuk kishim më forca rezervë. U vendos që në ndihmë të zonës të sillje një togë nga kompania e shtabit të

Përgjithshëm. Urdhri u dha me radio. Pas 30 minutash mbërrijnë përforsimet, me në krye Indrit Carën. Takohem përsëri me Indritin. Përqafohem. Në secilin nga ne kishte diçka intime për njëri – tjetrin. Ndoshta na dukej se ishim ndërmjetës për secilin, për vendlindjen, shkollat ushtarake ku kishim studiuar. Na u duk sikur do të niseshim në shtëpi, pranë prindërve dhe të tjerëve. Unë e dija se

ku do të shkonte Indriti me togën që po komandonte. Pas një minute do t’u jepja detyrën. Duke e përqaftuar, i thashë pa e larguar kokën nga e tija: pse erdhe, ne të kemi dërguar të na stërvitësh ushtarët. Ai më tha: Unë nuk kam ardhur këtu për të ngrënë fasule.

Indriti morri detyrën, që me togën e tij të rimerrte dhe të mbante majën e malit të Gallushës, me qëllim që të goditej armiku nga shpina, për t’u tërhequr prej luginës. Bora ishte e madhe. Të ftohtit ishte i jashtëzakonshëm, por toga e Indritit pasi e morri me sulm, qëndronte e patundur në majën e Gallushës. Detyra u realizua. Armiku kundërsulmoi përsëri, pas një përgatitje të gjatë me zjarr artilerie, por nuk mundi ta rimerrte majën e Gallushës. Sulmi i tij u thye me zjarr. Pati të vranë nga të dy anët. Bora e bardhë u bë e kuqe e errët prej gjakut. Në mbrëmje vonë, kur unë me Bislimin kishim mbërritur në Divjakë dhe po tereshim pranë një stufe, erdhi komandanti i kompanisë së shtabit, u kthye edhe ai nga luftimet, kur Bislimi e pyeti se a kishin pasur humbje në njerëz, ai nuk u përgjigj. Kjo më dogji, dhe menjëherë u ktheva nga ai dhe e pyeta: Mos është vranë gjë Kavaja?

Po, më tha Bislimi, është vranë Indriti... Nuk mbaj mend më se ç’ndodhi me mua. Mbaj mend kur më përmendën shokët. Isha tronditur së tepërmi. Kërkova të më shoqëronin atje ku e përgatisnin për herë të fundit dhe mbërrita pas një ore. Ishte natë. Kur shkova unë, shokët e kishin pastruar. E putha dhe i mbylla sytë, duke i dhënë

lamtumirën e fundit. Indriti u varros nën krismën e armëve në Negrofc. Menjëherë si përfundoi lufta, i ati i Indritit, Lulzimi, erdhi për të parë vendin ku i kish rënë i biri. Në çdo ngjarje të madhe kombëtare, Carajt i dhanë kombit tonë heronj.

Më 10 tetor 1999 eshtrat e Indrit Carës kthehen në vendlindje me helikopter. Helikopteri para se të ulej bën 2 rrotullime mbi qytetin e Kavajës dhe pastaj ulet në stadiumin e tij. Po këtë lloj përhëndetje bën helikopteri mbi qytet edhe kur largohet. Indriti u shndërrua dhe iu kthye si engjëll Kavajës dhe familjes së tij. Bashkia e qytetit të Kavajës dhe Këshilli i Rrethit e shpallën ‘Dëshmor të Atdheut’, ndërsa Presidenti i Republikës e dekoroi me dekoratën më të lartë: ‘Shqiponja e Artë’. Bashkia e qytetit, në nderim të tij, vendosi që bulevardi kryesor i qytetit të mbajë emrin e Indrit Carës si dhe shkolla 8-vjeçare ku ai pat kryer ato vite. Ceremonia mortore e ri-varrosjes së Indrit Carës ishte madhështore. Kurrë nuk e mban mend Kavaja një nderim të atillë. I gjithë qyteti ndaloj çdo lloj aktiviteti. Tregu nuk u hap. Funkciononin vetëm kafenetë, të cilat tregtonin vetëm kafe. Qyteti Kavajës ishte veshur në të zeza dhe flamuri kombëtar ishte ngritur në gjysmë shtize. Asnjë makinë nuk lejohej të qarkullonte në rrugën kryesore të qytetit. Kudo mbretëronte heshtja. Kavaja mbante zi për djalin e saj Hero, Indrit Carën, Kavajën. Prej stadiumit të qytetit për në familje, prej familjes në qendër të qytetit për homazhe, prej homazheve në qendër të sheshit të qytetit, që sot mban emrin e Indritit, dhe prej andej deri në banesën e tij të fundit, trupi i Indritit u përcoll nga orkestra frymore e Ushtrisë Shqiptare, e shoqëruar nga kolona dhjetëra-mijëshe e popullit të qytetit. Atë numër e rriste edhe më tepër ardhja e banorëve nga Durrësi me rrethina dhe të fshatrave të Kavajës, që janë me origjinë nga Kosova, si dhe me qindra refugjatë kosovarë që ende nuk ishin kthyer në Kosovë. Në krye të kolonës të pafundme njerëzore, që po e përcillte Indritin në përjetësi, ishin shokët e luftës së tij, që e mbanin atë në krah. Atje ishte e gjithë Shqipëria.



Pushtimi italian i Shqipërisë (7-12 prill 1939) ishte një fushatë e shkurtër ushtarake e Mbretërisë së Italisë kundër Mbretërisë së Shqipërisë. Konflikti erdhi si rezultat i politikës imperialiste të diktatorit italian Benito Mussolini.

Shqipëria u pushtua në mënyrë të shpejtë. Sundimtari i saj, Mbreti Zogu I u detyrua të largohej në Greqi dhe vendi u bë pjesë e Mbretërisë Italiane si një protektorat në bashkim personal me Kurorën Italiane.

Shqipëria kishte kohë që ishte me rëndësi të konsiderueshme strategjike për Mbretërinë e Italisë. Strategjistët detarë italianë lakmonin portin e Vlorës dhe ishullin e Sazanit në hyrje të gjirit të Vlorës, pasi do t'i jepnin Italisë kontrollin e hyrjes së detit Adriatik. Për më tepër, Shqipëria i mundësonte Italisë një pikë zbkimi, ku mund të hynin më tej në Ballkan. Në periudhën e vonshme osmane, me një zbehje të rëndësishme të Islamit, lëvizja nacionaliste shqiptare mori mbështetjen e fortë të dy fuqive të detit Adriatik, Italisë dhe Austro-Hungarisë, të cilat ishin të shqetësuara prej Pansllavizmit në Ballkan dhe hegjemonisë anglo-franceze që përfaqësohej nëpërmjet Greqisë në rajon.

Para Luftës së Parë Botërore, Italia dhe Austro-Hungaria kishin qenë mbështetëse të krijimit të një shteti shqiptar të pavarur. Në fillim të luftës, Italia kishte shfrytëzuar mundësinë për të pushtuar gjysmën jugore të Shqipërisë, për të parandaluar pushtimin prej Austro-Hungarezëve. Ky sukses nuk zgjati shumë, teksa rezistenca shqiptare me anë të Luftës së Vlorës dhe problemet vendore të pasluftës e detyruan Italinë për t'u tërhequr në 1920.

Dëshira për të kompensuar për këtë dështim do të ishte një nga motivet kryesore të Musolinit për të pushtuar Shqipërinë.

Shqipëria ishte e rëndësishme kulturalisht dhe historikisht për synimet nacionaliste të fashistëve italianë, pasi territori shqiptar kishte qenë pjesë e Perandorisë Romake prej kohësh, edhe para aneksimit të Italisë së veriut prej romakëve. Më vonë, gjatë Mesjetës, disa zona bregdetare (si Durrësi) ishin ndikuar dhe zotëruar prej fuqive italiane, kryesisht Mbretëria e Napolit dhe Republika e Venedikut për shumë vite. Regjimi fashist italian e legjitimizoi pretendimin mbi Shqipërinë nëpërmjet studimeve, duke deklaruar lidhjen racore midis italianëve dhe shqiptarëve, sidomos në krahasim me jugosllavët sllavë. Fashistët italianë pretenduan se shqiptarët ishin të lidhur nëpërmjet trashëgimisë etnike me italianët për shkak të lidhjeve midis popujve parahistorik të Italisë, Romakëve dhe Ilirëve, dhe se influenca madhore e treguar prej perandorive romake dhe venedikase mbi Shqipëri justifikonte të drejtën e Italisë për ta zotëruar.

Kur Musolini mori pushtetin në Itali, ai u kthye me interes të ri drejt Shqipërisë. Italia filloi të hynte në ekonominë shqiptare në vitin 1925, kur Shqipëria ra dakord për të lejuar Italinë që të shfrytëzonte burimet e saj minerare. Kjo u ndoq nga Pakti i Parë i Tiranës, në vitin 1926 dhe Pakti i Dytë i Tiranës, në vitin 1927, me anë të të cilëve Shqipëria dhe Italia hynë në një aleancë mbrojtëse. Midis gjërave të



7 prilli 'i pabesë' i shqiptarëve

Plot 84 vjet nga 7 prilli i vitit 1939, dita kur Shqipëria u pushtua nga Italia



tjera qeveria shqiptare dhe ekonomia subvencionoheshin nga kreditë italiane dhe Ushtria Mbretërore Shqiptare, jo vetëm që trajnohej nga instruktorë ushtarakë italianë, por shumica e oficerëve në ushtri ishin italianë; italianë të tjerë ishin të vendosur në vende të larta në qeverinë shqiptare. Një e treta e importeve shqiptare vinin nga Italia.

Pavarësisht influencës së fortë italiane, Mbreti Zog refuzoi të dorëzohej plotësisht ndaj presionit italian. Në vitin 1931 ai haptazi u çua kundër italianëve, duke refuzuar të rinovonte Paktin e vitit 1926 të Tiranës. Pasi Shqipëria nënshkroi marrëveshje tregtare me Jugosllavinë dhe Greqinë në 1934, Mussolini bëri një përpjekje të dështuar për të frikësuar shqiptarët, duke dërguar një flotë luftanijesh në Shqipëri.

Lindja e afërt e një fëmije mbretëror shqiptar kërcënonte që t'i jepte Zogut një dinasti që do të zgjaste. Pasi Hitleri pushtoi Çekoslllovakinë (15 mars 1939) pa njoftuar Musolinin më parë, diktatori italian vendosi që të vazhdonte me

aneksimin e tij të Shqipërisë. Mbreti i Italisë Viktor Emanueli III e kritikoi planin për të marrë Shqipërinë si një risk të panevojshëm. Roma, megjithatë, i dërgoi Tiranës një ultimatum, më 25 mars 1939, ku kërkonte dakordësi me pushtimin. Mbreti Zog refuzoi të pranonte para në këmbim të pranimit të një pushtimi dhe kolonizimi italian të Shqipërisë.

Qeveria shqiptare u përpoq ta mbante sekret lajmin e ultimatumit italian. Ndërsa Radio Tirana vazhdimisht transmetonte se asgjë nuk po ndodhte, njerëzit u bënë dyshues dhe lajmi i ultimatumit italian u shpërnda prej burimeve jozyrtare. Më 5 prill, i biri i mbretit lindi dhe lajmi u deklarua prej topave. Njerëzit u derdhën nëpër rrugë të alarmuar por lajmi i princit të sapolindur i qetësoi. Njerëzit ishin dyshues se diçka tjetër po ndodhte, gjë e cila çoi në një demonstratë anti-italiane në Tiranë në të njëjtën ditë. Më 6 prill kishte disa demonstrata në qytetet kryesore të vendit. Në po atë pasdite, 100 avionë italianë fluturuan

mbi Tiranë, Durrës dhe Vlorë, duke hedhur fletëpalosje që udhëzonin njerëzit t'i dorëzoheshin pushtimit italian. Populli ishte mjaft i zemëruar me këtë shfaqje force dhe kërkoi që qeveria të rezistonte dhe të lironte shqiptarët e arrestuar si "komunistë". Ndërsa një mobilizim i rezervistëve u thirr, shumë oficerë të lartë u larguan nga vendi. Gjithashtu, qeveria po zbehej. Ministri i Brendshëm, Musa Juka u largua për në Jugosllavi në të njëjtën ditë. Ndërsa Mbreti Zog transmetoi se do t'i rezistonte pushtimit italian, njerëzit ndiheshin sikur po braktiseshin nga qeveria e tyre.

Më 7 prill, trupat e Musolinit, të drejtuar nga gjeneral Alfredo Guzzoni, sulmuan gjithë portet e Shqipërisë njëkohësisht. Flota italiane përbëhej nga luftanijet "Giulio Cesare" dhe "Conte di Cavour", 3 heavy cruiser, 3 light cruiser, 9 destroyers, 14 torpedo, 1 minelayer, 10 anije ndihmëse dhe 9 anije transporti. Anijet u ndanë në katër

grupe dhe zbarkuan në Vlorë, Durrës, Shëngjin dhe Sarandë. Në Durrës, një forcë prej 500 shqiptarëve, xhandarëve dhe vullnetarëve, e udhëhequr nga Abaz Kupi (komandanti i xhandarmërisë së Durrësit), dhe Mujo Ulqinaku, i rezistuan forcave italiane. Të armatosur me armë të lehta dhe tre mitraloza, mbrojtësit rezistuan disa orë. Pas zbarkimit të një numri të madh të tankeve nga anijet, rezistenca u thye dhe brenda 5 orëve italianët morën qytetin.

Kur mëngjesin e 7 prillit 1939, filloi agresioni ushtarak italian kundër Shqipërisë, Zogu nuk i shpalli gjendjen e luftës Italisë dhe kjo që vetëvrasje politike, e cila e dëmtoi jo vetëm atë por edhe Shqipërinë. Kjo çoi në trajtimin e Zogut në Perëndim si emigrant i zakonshëm dhe jo si kryetar i një shteti demokratik. Pasi grabiti arkën e financës shtetërore u largua nga Shqipëria pa bërë asnjë deklaratë dhe sapo kaloi kufirin e shpërnda qeverinë, duke e lënë Shqipërinë pa qeveri antifashiste në mërgim. Me të dëgjuar këtë lajm, një masë e zemëruar njerëzish sulmoi burgjet, liroi të burgosurit dhe plaçkiti rezidencën e Zogut. Në orën 1:30 pasdite, në ditën e parë, të gjithë portet shqiptare ishin në duart e pushtuesve italianë. Në orën 9:30 të mëngjesit, ditën e 8 prillit, trupat italiane hynë në Tiranë dhe morën gjitha ndërtesat qeveritare. Kolonat e ushtarëve italianë marshuan drejt Shkodrës, Fierit dhe Elbasanit. Shkodra u dorëzua në mbrëmje pas 12 orëve luftime. Gjatë sulmit italian në Shkodër turma sulmoi burgjet dhe liroi 200 të burgosur.

Arratisja e Zogut krijoi në Shqipëri vakum institucional, i cili i dha mundësi Benito Musolinit për të manipuluar statusin politik të Shqipërisë sipas interesave të Italisë fashiste.

Më 12 prill, një Asamble Kombëtare e përbërë nga kolaboracionistë të rekrutuar nga qarqet monarkiste zogiste dhe qarqet antizogiste në emigracion shpalli se, në Shqipëri nuk kishte ndodhur okupacion ushtarak, por vetëm ndërrim i kreut të shtetit.

Ti ke forcën që nderon kombin! **APLIKO TANI!**



Kushte pagese dhe trajnimi si asnjëherë më parë.

Lehtësi aplikimi përmes e-Albania.

Afati për dorëzimin e

dokumentacionit pranë QPR-së

është deri në 07 prill 2023.